




Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



United Nations
ALBANIA



TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË

BASHKIA CËRRIK

PRILL 2021



Leave
No One
Behind



Autor:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve



© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky publikim duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Rruga "Brigada e VIII", Pall. LID, K.1, Z.1, Tiranë, Shqipëri

Email: info@observator.org.al

Webmail: www.observator.org.al

Ky publikim është realizuar nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori), në kuadër të projektit "Leave No One Behind" ("Askush të mos Mbetet Pas"), një Program i përbashkët i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) dhe zbatuar nga katër agjensi të OKB-së: UNDP, UNFPA, UNICEF dhe UN WOMEN në partneritet me Qeverinë Shqiptare. Ky projekt synon fuqizimin e personave vulnerabël në Shqipëri që të kenë akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të kenë një zë në vendimarrjen publike, që ndikon në jetën e tyre dhe t'i kërkojnë llogari zyrtarëve publikë, duke i mbajtur përgjegjës për dështimet apo arritjet.

Një falenderim i shkon stafit të *Bashkisë së Cërrikut* që ka bashkëpunuar me Observatorin dhe ka mundur të dhënat ndër vite mbi aktivitetet dhe buxhetin e planifikuar për të rejat dhe të rinjtë. Në veçanti, falenderojmë Z. Andis Salla – Kryetar i Bashkisë Cërrik, Znj. Alketa Binjaku – Drejtore e kabinetit në Bashkinë e Cërrikut, Znj. Entela Mustafa – Specialiste për hartim projekti dhe strehim dhe Z. Mateo Belshi - përgjegjës i Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Bashkinë e Cërrikut.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Observatorit, në emër të Rrjetit të Organizatave "Zëri i të Rinjve". Opinione të shprehura këtu janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet e UNFPA-së, UN Albania apo SDC.

PËRSE BUXHETIMI “PËR RININË” DHE “ME RININË”?

Rinia në Shqipëri është pjesë e programit dhe politikave të qeverisë dhe citohet si grup prioritar në dokumenta të veçantë të hartuar për këtë qëllim.

Programi i Qeverisë 2017-2021 në seksionin e rinisë, parashikon hartimin e politikave për përmirësimin e cilësisë së jetës, rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën politike, programe dhe projekte për nxitjen e punësimit, krijimin e një kuadri ligjor të qartë për rininë ku përcaktohen qartë kompetencat e niveleve të ndryshme të qeverisjes lidhur me përgjegjësitë që kanë ndaj të rinjve, si dhe forcimin e rrjetit të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Ofrimi i një tërësie shërbimesh dhe informacionesh edukuese në fushën e shëndetësisë, arsimit, punësimit, zhvillimit ekonomik, kulturës, sportit, argëtimit, mjedisit e vullnetarizimit, si dhe angazhimi i rinisë në proceset planifikuese e vendimmarrëse, është domosdoshmëri. Këto shërbime mund dhe duhet të ofrohen kryesisht nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore (bashkitë), të cilat janë më afër qytetar/eve dhe njohin më mirë nevojat e tyre. Të rejat dhe të rinjtë duhet të jenë pjesë e iniciativave planifikuese e zhvilluese të ndërmarra si në nivel qendror, ashtu edhe nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sidomos nga bashkitë.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyra dhe kompetenca specifike për rininë, të diktuar nga ligje të ndryshme dhe plane strategjike kombëtare. Më poshtë paraqiten **kompetencat për rininë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore**:

1. Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si një nga ligjet bazë mbi të cilin organizojnë punën dhe funksionojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, ka të shprehur qartësisht detyrimin dhe përgjegjësinë për trajtimin me prioritet të rinisë. Konkretisht këto detyrime evidentohen në:

- (i) *Nenin 3*, ku përcaktohet misioni i vetëqeverisjes vendore, në pikat d), dh) dhe f) sipas të cilave realizimi i shërbimeve duhet të bëhet në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e antar/eve të bashkësisë, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj apo akte të tjera normative, si dhe përmes nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- (ii) *Nenin 23*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e

infrastrukturës dhe shërbimeve publike (kryesisht në mirëmbajtjen e institucioneve arsimore apo zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në fushën e shëndetësisë, etj);

- (iii) *Nenin 24*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e shërbimeve sociale;
- (iv) *Nenin 25*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
- (v) *Nenin 26*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- (vi) *Nenin 28*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor;
- (vii) *Nenin 29*, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e sigurisë publike.

Garantimi i pjesëmarrjes publike të grupeve të ndryshme shoqërore në procesin e vendimmarrjes shprehet qartësisht edhe në nenin 16 të këtij ligji, ku përcaktohet detyrimi për konsultime publike nga Njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2. Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i cili në:

- (i) *Nenin 38, pika 2* përcakton që pas finalizimit të projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore të marrë masa për publikimin e tij dhe më pas të organizojë seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit¹. Në këtë kuadër, bashkitë mund dhe duhet të mbështetnin iniciativat planifikuese buxhetore për të rehat dhe të rinjtë në linjë me nevojat e këtij grupi, duke u udhëhequr dhe zbatuar legjisllacionin në fuqi dhe dokumentat kryesorë strategjikë të hartuar për këtë qëllim.

3. Ligji 75/2019 “Për rininë”, si një ligj bazë për mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse, krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve, përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, si dhe bashkëpunimin me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë. Kompetencat e njësisë së vetëqeverisjes vendore për rininë në këtë ligj përcaktohen në:

¹ Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 38, pika 2, fq. 16

(i) *Nenin 5*, ku theksohet se njësia e qeverisjes vendore duhet të:

- Bashkëpunoj me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) për politikat, projektet e programet në fushën e rinisë;
- Kontriboj në ofrimin e veprimtarive për të rinjtë në bashkëpunim me MASR, institucione dhe autoritete të tjera vendore, duke përcaktuar standardet në ofrimin e veprimtarive rinore dhe punës me rininë.

(ii) *Nenin 7*, ku përcaktohen kompetencat specifike të njësive të vetëqeverisjes vendore, si më konkretisht:

- Njësitet e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për:
 - pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre;
 - krijimin e këshillit vendor të rinisë;
 - organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve;
 - organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve;
 - nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre;
 - financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta;
 - krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë;
 - parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore;
 - mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.
- Njësitet e vetëqeverisjes vendore mund të aplikojnë për t'u mbështetur nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare për rininë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në fuqi.
- Për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë nen, njësitet

e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me organizatat për të rinjtë e organizatat rinore shqiptare në diasporë, për të mbajtur komunikimin me të rinjtë shqiptarë që janë larguar nga vendi për arsye studimesh ose të tjera, me qëllim angazhimin në aktivitetet që zhvillohen në Republikën e Shqipërisë.

(iii) Nenin 10, ku përcaktohet se:

- Këshilli vendor i rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë kryetarit të bashkisë. Këshilli vendor i rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;
 - vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
 - propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
 - bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.
- Këshilli vendor i rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga të paktën 4 deri në 6 anëtarë, ku të paktën gjysma e anëtarëve përfaqësojnë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.
- Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të këshillit vendor të rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të këshillit vendor të rinisë miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke i'u referuar, për aq sa është e mundur, kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.

SI PARAQITET SITUATA PËR TË RINJTË NË BASHKINË CËRRIK?

Vizioni i Bashkisë Cërrik është mundësimi i një mjedisi në të cilin gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Cërrikut, pavarësisht moshës, karakteristikave personale, nevojave të veçanta, grupit etnik e social, përkatësisë fetare, orientimit seksual apo identitetit të tyre gjinor, njohin, pranojnë dhe respektojnë parimin e barazisë në të gjitha fushat e jetës. Në planifikimet dhe ndërhyrjet në shërbim të komunitetit, pra përfshirë edhe rininë, Bashkia Cërrik orientohet, veç të tjerash, përmes:

- i. *Planit Social Vendor 2019 - 2023*, të miratuar në vitin 2019; si një dokument i rëndësishëm për Bashkinë për të parashikuar dhe ngritur një sistem efektiv shërbimesh të kujdesit shoqëror që adreson nevojat e kategorive vulnerabël duke koordinuar përpjekjet e të gjithë aktorëve publik e jo publik që kanë role e përgjegjësi në këtë këndvështrim.
- ii. *Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore Shtator 2020 - Shtator 2023*, si një mjet i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të angazhimeve publike të ndërmarra nga Bashkia Cërrik në lidhje me parimet e barazisë, planifikimit dhe zbatimit të nevojave dhe të të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve;
- iii. *Buxhetit vjetor*, në të cilin Bashkia Cërrik ka parashikuar dhe miratuar lehtësimet fiskale për bizneset që do të ngrihen nga të rejtat/ të rinjtë dhe gratë në mbështetje të iniciativave të ndërmarra prej tyre. Lehtësirat fiskale janë të specifikuara për të rejtat/ të rinjtë dhe gratë nën 25 vjeç, që përfitojnë 20% ulje të detyrimeve vjetore. Kjo mbështetje për vitin 2020 ka qenë 100% për bizneset e hapura, duke mbështetur 3 sipërmarrje/ biznese të tilla me fokus:
 - a. Artikuj industrial;
 - b. Qendër kërcimi;
 - c. Qendër estetike.

Bazuar në informacionin e dhënë nga bashkia, **situata në lidhje me të rejtat dhe të rinjtë në Bashkinë Cërrik paraqitet si në vijim:**

- Bashkia Cërrik nuk disponon të dhëna për numrin e të rejave dhe të rinjve të grupmoshës 15-29 vjeç.
- Në Cërrik ka gjithsej 4 (katër) shkolla të mesme të përgjithshme, 1 (një) shkollë profesionale, nuk ka universitet, ka 1 (një) godinë të një qendre multi-funksionale, e cila për momentin nuk ofron shërbime.

- Në këtë Bashki ushtron veprimtarinë një grupim rinor informal i quajtur "Grupimi 5 Plus".
- ***Bashkia Cërrik ka ngritur një bord rinor*** si një grup zyrtar i të rinjve aktivë dhe vullnetarë, të cilët sjellin zërin e të rinjve të tjerë në vendimmarrje. Disa nga të dhënat mbi bordin rinor të Bashkisë Cërrik janë:
 - Bordi rinor është themeluar me iniciativën e Bashkisë Cërrik në maj të vitit 2018, si një grupim të rejash dhe të rinjsh vullnetarë që kanë marrë pjesë në aktivitete dhe nisma të Bashkisë. Më pas me mbështetjen e USAID, grupimi i vullnetarëve u formalizua në bord rinor.
 - Për ngritjen e bordit rinor nuk është ndjekur ndonjë praktikë analoge e suksesshme në ndonjë bashki tjetër.
 - Bordi rinor përbëhet nga 20 anëtarë të grupmoshës 15-20 vjeç (10 vajza dhe 10 djem).
 - Përfshirja e të rinjve dhe të rejave në bord ka qenë dhe është vullnetare. Të rejat dhe të rinjtë që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e bordit, janë anëtarësuar duke dhënë kontribut vullnetar të vazhdueshëm.
 - Bordi rinor herë pas here ka ngritur shqetësime dhe kërkesa të të rejave dhe të rinjve që jetojnë në Bashkinë Cërrik, të cilat kanë qenë kryesisht të lidhura me krijimin e ambjenteve sportive, këndeve lojrave dhe argëtimit. Bazuar në kërkesat e ngritura, Bashkia Cërrik ka investuar në krijimin e më shumë hapësirave sportive, këndeve sportive në shkolla, kënde lojrash, fusha futbollit etj. Gjithashtu Bashkia ka ardhur në shtetë kinemasë në qendrën multifunksionale të qytetit për të rikthyer jetën artistike dhe kulturore.
 - Bordi rinor ka ndërmarrë nisma konkrete për të rinjtë, siç janë ndihmat për njerëzit në nevojë.
- ***Bordi rinor në Bashkinë Cërrik ka hartuar një Plan veprimi për të rinjtë*** në maj të vitit 2018. Në këtë plan çështjet dhe nevojat kryesore të identifikuar nga të rinjtë e Cërrikut janë:
 - Mungesa e mundësive për punësim (punësim rinor);
 - Mungesë e arsimit profesional (nevojë për kurse të reja);
 - Mungesa e aktiviteteve kulturore dhe ambjenteve zbavitëse;

- Mungesë vizioni (mentalitet i vjetër, indiferentizëm);
- Politizim i skajshëm;
- Çështjet e sigurisë (përdorimi i lëndëve narkotike, dhuna/ bullizmi).

Ndërsa, prioritetet për rininë të identifikuar në Plan veprimin për të rinjtë në Bashkinë Cërrik janë:

- Aktivizmi rinor;
 - Punësimi dhe formimi profesional;
 - Rritja e bashkëpunimit mes Bashkisë dhe institucioneve lokale për çështjet rinore;
 - Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve (trajnime);
 - Angazhimi dhe përmirësimi i çështjeve të sigurisë publike.
- Në Planin Social të Bashkisë Cërrik 2019 – 2023, një rëndësi tejet të veçantë ka sektori i shërbimeve sociale, falë partneriteteve të suksesshme me organizata jofitimprurëse dhe donatorë duke mundësuar riintegrimin social dhe fuqizimin e individëve madhor të familjeve vulnerabël. Në mënyrë të veçantë këto programe targetojnë komunitetin rom dhe egjiptian, fëmijët në nevojë për mbrojtje, gratë viktime dhunës në familje, të rinjtë e papunë, familjet e kthyer nga emigracioni etj.
 - Bashkia e Cërrikut bashkëpunon me organizata të ndryshme për tematikat e të rinjve. Bashkia e Cërrikut ka nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi 2 vjeçare (2020 - 2021) me **Observatorin, në emër të rrjetit të organizatave "Zëri i të Rinjve"**, me qëllim mobilizimin, integrimin dhe fuqizimin e potencialeve të të rejave dhe të rinjve përmes shërbimeve ndërgjegjësuëse, informuese, avokuese e lobuese, në fushat e edukimit, kujdesit, shëndetit dhe punësimit.
 - Me mbështetjen e "Save the Children" dhe në partneritet me organizatën "Ndihmë për fëmijët", Bashkia Cërrik po zbaton projektin "Aftësimi profesional dhe personal i të rinjve në nevojë dhe dhënien e mundësive për të dalë nga cikli i varfërisë". Ky projekt që zbatohet në periudhën 2016-2021 mbështet të rinjtë në nevojë për rritjen e aftësive sipërmarrëse, konceptimin, ngritjen dhe zhvillimin e nismave të tyre të sipërmarrjes/ bizneseve, duke ofruar:

- Trajnim dhe këshillim për konceptin e ideve të biznesit;
 - Trajnim dhe këshillim për përgatitjen e planeve praktike të biznesit;
 - Mbështetje për testimin e aftësive dhe nismave të biznesit;
 - Mbështetje financiare për idetë më të mira në ngritjen e biznesit;
 - Këshillim për zhvillimin e rritjen e mëtejshme të biznesit.
- Bashkia Cërrik **ka një sektor dedikuar rinisë** (Kultura, Rinia dhe Sporti).
 - Bashkia Cërrik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbi bazën e të cilit, në përputhje me ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore, bëhet dhe planifikimi buxhetor vjetor. Aktualisht Bashkia Cërrik ka në zbatim **PBA 2019 - 2021 "Buxheti i qytetarit, për qytetarin"**. Në këtë PBA, të rinjtë janë të përfshirë në:
 - *Programin për rininë dhe sportet*, në të cilat shërbimet specifike për të rinjtë janë në lidhje me:
 - a. Informimin dhe këshillimin e të rinjve për shërbimet lokale;
 - b. Edukimin dhe informimin për formim profesional;
 - c. Vlerësimin e nevojës për mbështetje të të rinjve;
 - d. Koordinimin e grupeve, shoqatave dhe OJF-ve rinore;
 - e. Bashkëfinancim të aktiviteteve rinore;
 - f. Bashkërendimin me sektorin e shërbimeve sociale, shëndetësore e të sportit për nxitjen e aktiviteteve më të rinj;
 - g. Organizimin e përvitshëm të aktiviteteve sportive dhe zhvillimi i sportit në komunitet, të cilat forcojnë traditën ku të rinjtë dhe të rejat e bashkisë Cërrik, shoqatat e klubet sportive nga vendi ose nga rajoni garojnë në mes tyre.
 - *Programin kujdesi social për familjet dhe fëmijët*, në të cilin të rinjtë janë përfshirë në fushën e shërbimeve dhe mallrave të ndryshme që u jepen familjeve, të rinjve ose fëmijëve (si qendra pushimi ose zbavitjeje).

Sipas PBA 2019 - 2021 në Bashkinë e Cërrikut, kategoria e të rinjve nuk është e buxhetuar në mënyrë direkte nëpërmjet aktiviteteve dhe programeve apo shërbimeve të caktuara. Megjithatë departamentet/ programet në

Bashki, buxheti i të cilave i dedikohet direkt ose indirekt rinisë janë:

- Sektori i arsimit, sportit, kulturës;
- Shërbimet sociale.

Përsa i përket fushës së arsimit, Bashkia mbulon shpenzimet operacionale, pagat dhe investimet në infrastrukturë. Ndërsa fushën e shërbimit social, Bashkia e mbështet me pagesën e aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike dhe pagat. Ndër vite Bashkia Cërrik ka mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nisma dhe aktivitete për të rinjtë. Sipas të dhënave të Zyrës së Financës në Bashkinë Cërrik, ***për çdo vit janë shpenzuar rreth 2 milion lek për aktivitete me rininë***. Natyra e aktiviteteve që janë mbështetur me këtë fond është si më poshtë:

- Aktivitete argëtuese;
- Aktivitete ndërgjegjësuere dhe sensibilizuese (fushata, trajnime, takime, konkurse etj).

Buxheti i bashkisë dedikuar indirekt për rininë ***është pjesë e programeve buxhetore***, që paraqiten në tabelën në vijim:

Viti	Kategoria	Buxheti i planifikuar (000/lekë)	Buxheti i shpenzuar (000/lekë)
2016	Arsimi	108.103	108.103
	Shërbimet sociale	239.999	239.999
2017	Arsimi	99.258	99.258
	Shërbimet sociale	226.205	226.205
2018	Arsimi	91.843	86.327
	Shërbimet sociale	266.946	266.946
2019	Arsimi	116.249	116.249
	Shërbimet sociale	227.548	227.548
2020	Arsimi	84.371	84.371
	Shërbimet sociale	332.841	332.841
2021	Arsimi	67.665	
	Shërbimet sociale	118.812	

Sikurse shikohet nga të dhënat e tabelës së mësipërme:

- **Planifikimi i buxhetit për programin e arsimit** nga viti 2020 (ka qenë 84.371) në vitin 2021 (është 67.665) është *ulur me 16,706 (000/lekë)*. Ndërsa vlera më e lartë e buxhetit të planifikuar për këtë program është 116.249 (000/lekë) në vitin 2019.
- **Planifikimi i buxhetit për programin e shërbimeve sociale** nga viti 2020 (ka qenë 332.841) në vitin 2021 (është 118.812) është *ulur me 214,029 (000/lekë)*. Viti 2020 ka shënuar vlerën më të lartë të buxhetit të planifikuar për këtë program, ndërsa viti 2021 ka shënuar vlerën më të ulët të buxhetit të planifikuar.
- Njoftimet e ndryshme mbi çështjet sociale, shëndetësore, arsimore etj pasqyrohen online në faqen e internetit të bashkisë së Cërrikut www.bashkiacerrik.gov.al. Në këtë faqe zyrtare:
 - Në kategorinë e shërbimeve, Bashkia Cërrik pasqyron informacione mbi shërbimet e ndryshme që ofron Bashkia si: shërbimet publike, shërbimet sociale etj.
 - Në kategorinë "Programi i transparencës" jepet një informacion i detajuar në lidhje pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje, kërkesës për informim etj.
 - Bashkia ofron dhe një kategori më vete për *regjistrin e ankesave dhe kërkesave*, që qytetarët mund të kenë për çështje të ndryshme.
 - Në kategorinë "Këndi i BE", jepen informacione të detajuara në lidhje me programet dhe fondet e Bashkimit European (BE), projektet e financuara nga BE, vlerësimin e performancës në procesin e integritimit në BE etj.
 - Njoftimet për konsultimet publike publikohen në kategorinë "Konsultime me publikun". Platforma online mbi konsultimet publike ofron mundësinë që të gjitha palët relevante të jenë të ftuara dhe të përfshira në procesin e konsultimit publik për nismat legjislative dhe procesin e vendimmarrjes dhe të politikë bërjes.
- Bashkia Cërrik ***nuk ka bërë ndonjë anketim për të vlerësuar nevojat apo prioritetet e të rinjve, por ka organizuar seanca dëgjimore të veçanta për problemet e rinisë***, ku ndër problemet e rinisë të identifikuara kanë qenë:

- Mungesa e shërbimeve për të rinjtë dhe të rejt;
- Mungesa e aktiviteteve argëtuese, sportive dhe kulturore;
- Mungesa e mbështetjes së të rinjve dhe të rejave me bursa specifike studimi;
- Mosinformimi për këshillim karriere, stazhet e punës etj.

Përfaqësues të sektorit të rinisë në Bashkinë Cërrik shprehen se të rinjtë mund të adresojnë problematikat e tyre nëpërmjet takimeve të ndryshme që organizohen, komunikimit në rrjetet sociale, komunikimit direkt me përfaqësues të Bashkisë etj.

- Kur pyetet për **rëndësinë e aktiviteteve me fokus shëndetin seksual e riprodhues**, si dhe ato sensibilizuese për shëndetin dhe kujdesin shëndetësor, Bashkia Cërrik i vlerëson si aktivitete shumë të rëndësishme, së bashku me:
 - Krijimin e Bordeve/ Këshillave konsultues të përbashkët ndërmjet bashkisë dhe organizatave rinore;
 - Pasjen e një manuali shpjegues për të rejtat e të rinjtë për t'u njohur me të drejtat e tyre mbi shëndetin e kujdesin shëndetësor;
 - Shkëmbimin e eksperiencave mes të rejave e të rinjve nga bashki të ndryshme me ndërmjetësimin e drejtuesve vendor.

Bashkia Cërrik e shikon kujdesin shëndetësor të të rinjve si një fushë që duhet të marrë vëmendjen e duhur në mënyrë që brezat e ardhshëm të jenë më të gatshëm të përballen me problematikat e kohës të lidhura kryesisht me shëndetin fizik e mendor. Bashkia Cërrik duhet të ketë rol në kujdesin shëndetësor të të rinjve dhe kjo konsiston në bashkëpunime dhe mbështetje në fushata të ndryshme me fokus mirëqenien shëndetësore, fizike dhe mendore të të rinjve.

ZBATIMI I PROGRAMEVE/ PROJEKTEVE/ AKTIVITETEVE PËR TË RINJTË GJATË PANDEMISË GLOBALE COVID-19

○ **Ndikimi i pandemisë globale COVID-19 në zbatimin e programeve/ projekteve/ aktiviteteve për të rinjtë**

Pandemia globale e COVID-19 ndikoi në çdo fushë të jetës dhe veprimtarisë. Ndikimi ishte i dukshëm dhe në planifikimet dhe realizimet e aktiviteteve të ndryshme me fokus të rinjtë dhe për të rinjtë nga ana e Bashkisë Cërrik. Të kushtëzuar nga protokollet e zhvillimit të aktiviteteve dhe masave anti-COVID, aktivitetet:

- U përshtatën dhe u realizuan nëpërmjet platformave online (Zoom, GoToMeeting etj);
- U realizuan në terren në përputhje me zbatimin e protokollit të masave anti-COVID, me një numër të kufizuar pjesëmarrësish (6-7 persona) të pajisur me masa mbrojtëse (maska, dezinfektantë etj) dhe duke respektuar distancimin fizik nga njeri-tjetri;
- U planifikuan për t'u zhvilluar më vonë.

Disa nga aspektet pozitive të zhvillimit të aktiviteteve të tilla online ose fizikisht duke respektuar masat dhe protokollet anti-COVID të diktuar nga Qeveria Shqiptare, janë:

- Siguri dhe mbrojtje e të rinjve nga ekspozimi ndaj COVID-19;
- Informimi virtual dhe vazhdimi i punës nëpërmjet platformave online;
- Njohja me risitë e platformave të ndryshme virtuale, gjithnjë e më të pranishme e domosdoshme për zhvillimin e aktiviteteve.

Disa nga aspektet negative të zhvillimit të aktiviteteve të tilla online ose fizikisht duke respektuar masat dhe protokollet anti-COVID të diktuar nga Qeveria Shqiptare, janë:

- Mungesa e kushteve të duhura për realizimin e aktiviteteve online (mungesa e internetit, pajisjeve kompjuterike etj);
- Pamundësia për të monitoruar dhe vlerësuar nëse aktivitetet e realizuara online kanë patur një impakt tek pjesëmarrësit;
- Mungesa e aktivizimit dhe interaktivitetit të pjesëmarrësve;
- Zhvillimi i aktiviteteve në këto formate nuk ka qenë shumë produktiv apo me impakt konkret në krahasim me formatet e mëparshme të zhvillimit të tyre.

- **Fond i dedikuar për situatat e emergjencave në buxhetin vjetor të Bashkisë dhe mbështetja nga partnerë të ndryshëm**

Fondi i emergjencave të fatkeqësisë natyrore është një detyrim ligjor sipas nenit 65 të ligjit Nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" për bashkitë në vend. Ligji parashikon që secila bashki të planifikojë minimalisht 4% të buxhetit për emergjencat civile. Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si më poshtë:

- a) nga të ardhurat e veta vendore;
- b) nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet;
- c) si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

Ky fond përdoret në bazë të natyrës së emergjencës duke ofruar ndihmën e duhur nga pushteti vendor për komunitetin e tij.

Situata emergjente e krijuar nga COVID-19, bëri bashkë shumë institucione dhe biznese në Cërrik për t'u gjendur më pranë komunitetit. Në nismat e Bashkisë u përfshin 8 biznese dhe 7 organizata të shoqërisë civile, duke shpërndarë pako ushqimore dhe higjieno-sanitare, mbështetje me medikamente dhe ndihma për të kryer pazaret (ushqimet dhe mjetet e nevojshme) për të moshuarit. Nga këto nisma kanë përfituar rreth 3,000 familje e individë në nevojë. Gjithashtu u asistuan me shërbime në banesë rreth 1,000 të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuar.

Bashkëpunimi ndër-institucional (bashkia, shkolla, zyra arsimore, policia, qendra shëndetësore, zyrat e punës, organizatat etj) në Bashkinë Cërrik për t'ju përgjigjur nevojave të të rinjve gjatë COVID-19 ka qenë shumë i mirë dhe frytdhënës. Të gjithë bashkë kanë dhënë kontributin e tyre që t'i gjenden sa më afër të rinjve dhe gjithë komunitetit.

Të rinjtë, sikurse dhe kategoritë e tjera, kanë përfituar në mënyrë indirekte nga përdorimi i fondit të emergjencave nga Bashkia e Cërrikut. Gjithashtu të rinjtë dhanë një kontribut shumë të vlefshëm në situatën e krijuar. U trajnuan rreth 30 të rinj dhe të reja për raportimin mbi rastet që kanë nevojë për mbështetje nga situata e krijuar nga pandemia e COVID-19. Të rinjtë ndihmuan në blerjet e nevojshme të përditshmërisë për rreth 1,000 të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuar në Bashkinë e Cërrikut. Disa prej nevojave të të rinjve që u mbuluan përgjatë kësaj periudhe janë:

- Ofrimi i informacionit të nevojshëm për t'u mbrojtur nga situata e krijuar;
- Sigurimi i disa nevojave të familjeve të tyre;
- Mbështetja me konsulta të ndryshme etj.

Përgjatë periudhës së COVID-19, të rinjtë që jetojnë në Bashkinë Cërrik kanë qenë të pranishëm në aktivitete të ndryshme të realizuara. Organizatat dhe zyrat përkatëse që kanë në fokus të rinjtë, kanë hartuar planet e tyre për të aktivizuar të rinjtë dhe të rejat në aktivitete online, duke sensibilizuar dhe komunikuar me njëri tjetrin dhe me specialistë të fushave të ndryshme.

○ **Sugjerime mbi masat që duhet të ndërmerren nga Bashkia Cërrik në situata emergjente**

Nga eksperiencia e fituar nga COVID-19, disa nga sugjerimet që mund të bëjë Bashkia Cërrik për të rinjtë në një kontekst emergjence janë:

- Hartimi i një plani paraprak për të rinjtë, sesi ata mund të luajnë një rol të rëndësishëm për të mbështetur kategoritë në nevojë dhe sesi të rinjtë duhet të mbështeten/ mbrohen nga periudha e izolimit/ distancimit fizik;
- Plan i koordinuar masash ndërmjet disa institucioneve lokale me të cilat bashkia punon, që kanë në fokus fusha të rëndësishme për mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve, si: arsimi, shëndetësia, mbrojtja sociale, punësimi, vullnetarizmi etj;
- Bashkëpunim i ngushtë i bashkisë me organizatat rinore dhe/ ose që kanë në fokus punën me të rinjtë;
- Në të ardhmen është e nevojshme që të ketë me shumë njësi organizative për shpërndarjen më të gjerë dhe uniforme të ndihmës/ mbështetjes në të gjithë territorin e bashkisë, duke pasur një fokus më të veçantë në grupet më vulnerabël dhe nevojë.

TË DHËNA MBI TË RINJTË NGA ANKETIMI I REALIZUAR NË BASHKINË CËRRIK

Nga një anketim i kryer nga UNFPA me ekspertizën e Observatorit, me 100 të reja e të rinj të Bashkisë Cërrik (62% vajza dhe 38% djem) gjatë periudhës nëntor 2020 (të dhënat e plota gjenden në linkun: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2021/01/Factsheet-Te-Rinjte-Bashkia-Cerrik-Dec2020.pdf>) rezultojnë se:

- Afërsisht **1 në 5 të reja dhe të rinj** kanë dëgjuar se çfarë janë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sustainable Development Goals - SDGs). **Shkolla (60%)** është burimi kryesor i marrjes së këtij informacioni për të rejtat dhe të rinjtë e zonave urbane dhe **familja (53%)** është burimi kryesor për të rejtat dhe të rinjtë e zonave rurale. Asnjë prej të rinjve të anketuar në zonat rurale nuk është shprehur se ka dëgjuar për SDGs nga shkolla, organizatat e shoqërisë civile apo televizioni. Gjithashtu asnjë prej të rinjve të anketuar në zonat urbane nuk është shprehur se ka dëgjuar për SDGs nga interneti apo televizioni.
- Vetëm **2% e të rejave dhe të rinjve të grupmoshës 15 – 18 vjeç** shprehen se **janë përfshirë personalisht në arritjen e SDG-ve dhe 5% e tyre janë përfshirë pjesërisht**, ndërsa **gjithë pjesa tjetër** e të rinjve të grupmoshave të ndryshme shprehen se **nuk janë përfshirë**.
- **20% të rejave dhe të rinjve shprehen se nuk kanë marrë ndonjëherë informacion** mbi shëndetin seksual dhe riprodhues.
- **42% e të rejave dhe të rinjve** shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është **pjesërisht i mjaftueshëm**. **20% e të rejave dhe të rinjve në zonat urbane** shprehen se informacioni i marrë në shkollë mbi shëndetin seksual dhe riprodhues është **i mjaftueshëm**, përkundrajt **26% të të rejave dhe të rinjve në zonat rurale**. Shumica e të anketuarve që shprehen se informacioni i marrë është i pamjaftueshëm vijnë nga zonat urbane.
- **6% e të rejave dhe të rinjve në zonat rurale** dhe **4% e të rejave dhe të rinjve në zonat urbane flasin me prindërit** e tyre mbi çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues. Për të rinjtë është më e lehtë që të komunikojnë vetëm me mamën (7% në zonat urbane dhe 26% në

zonat rurale), si dhe me shokët/ shoqet (19% në zonat rurale dhe 14% në zonat urbane).

- **1 në 3 të reja dhe të rinj** janë në dijeni të programeve/ prioriteteve të bashkisë (kryesisht djemtë në zonat urbane në masën 67%). Ndërsa grupi më pak i informuar janë vajzat nga zonat rurale në masën 30%.
- Një pjesë e konsiderueshme e të rejave dhe të rinjve (32% në zonat urbane dhe 47% në zonat rurale) shprehen se **nuk kanë marrë ndonjëherë pjesë në takimet** që bashkia ka zhvilluar me të rejat dhe të rinjtë për përcaktimin e prioriteteve të zhvillimit të zonës. Një pjesë e tyre (22% e të rinjve nga zonat rurale dhe 14% e të rinjve nga zonat urbane) janë shprehur se nuk janë në dijeni të këtyre takimeve. Faqja zyrtare e bashkisë (për 46% të të rejave dhe të rinjve të zonave urbane dhe për 33% të të rejave dhe të rinjve nga zonat rurale) është mjeti më i përdorur për marrjen e informacionit nga bashkia. Njoftimet publike mbeten gjithashtu mjete informuese të përdorura nga të rejat dhe të rinjtë.
- **Aktivitetet sociale, informuese, ndërgjegjësuese, argëtuese dhe sportive** janë programet më të preferuara që të rinjtë do të donin të përfitonin nga Bashkia e Cërrikut. Me prioritet nga të rejat dhe të rinjtë janë vlerësuar edhe krijimi i qendrave rinore; bursa për studentët ekselentë; etj.

ÇFARË MUND TË PËRFSHIHET PËR RININË NË BUXHETIN E VITIT 2022 TË BASHKISË CËRRIK?

Bashkia Cërrik, në përmbushje të detyrimeve dhe përgjegjësi të saj për përmirësimin e situatës së të rejave dhe të rinjve të Cërrikut, në zbatim të Ligjit 75/2019 “Për rininë”, mund të përfshijë në planifikimin buxhetor vjetor, disa nga veprimet që përshkruhen në vijim:

QËLLIMI	VEPRIMI / PROJEKTI	KOHËZGJATJA	TREGUES	Detajime mbi rolin e Bashkisë
1. Nxitja dhe pjesëmarrja e të rejave dhe të rinjve në proceset dhe vendimmarrjet demokratike	1.1. Fuqizimi i veprimtarisë së Bordit Rinor, i parashikuar si një kompetencë e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe në Ligjin 75/2019 “Për rininë” duke respektuar balancën gjinore si dhe përfaqësimin e të rejave dhe të rinjve nga grupe të pafavorizuara (persona me aftësi të kufizuara, minoriteti Rom, Egjiptjan, komuniteti LGBTI, etj).	- <i>Dhjetor 2021</i> Aktivitete trajnuese për anëtarët e Bordit Rinor, i kryesuar nga kryetari i Bashkisë. Janar 2022 - e në vijim: Aktivizimi i këtij Bordi në mbledhjet dhe proceset vendimmarrëse të bashkisë.	- Lista e antarë/eve të Bordit Rinor, publikuar në faqen e internetit të bashkisë Cërrik. - Pjesëmarrja dhe diskutimi i tyre pasqyruar në proces-verbalet e mbledhjeve përkatëse.	Bashkia Cërrik mer masa që Bordin Rinor ta ketë fuqizuar
	1.2. Përfshirja e dimensionit gjinor dhe rëndësisë së pjesëmarrjes së barabartë në përfaqësimin dhe jetën politike, në sesione për edukimin qytetar, në shkollat publike (të mesme).	<i>Gjatë gjithë viteve 2021 - 2022</i>	- Numri i aktiviteteve me fokus diskriminimin gjinor dhe përfshirjen e rinisë në vendimmarrje, të organizuara nga bashkia në 4 shkollat e mesme të përgjithshme dhe 1 shkollë profesionale në Bashkinë Cërrik. - Numri i të rejave dhe të rinjve të pranishëm si dhe që japin mendim në mbledhjet e Këshillit Bashkiak apo seancat/ dëgjesat publike që organizon bashkia për çështje të ndryshme.	Bashkia Cërrik organizon dëgjesa publike duke pasur në konsideratë respektimin e balancës gjinore. Aktivizmi rinor është një prej prioritetëve të përcaktuara në Plan veprimin për të rinjtë nga Bashkia Cërrik.
	1.3. Takime sensibilizuese me të rejtat e zonave rurale dhe urbane, si dhe me të rejtat me aftësi të kufizuara, mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të tyre në procesin e votimit (individual e të lirë), në zgjedhjet vendore dhe qendrore.	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Numri i takimeve sensibilizuese të organizuara. - Numri i pjesëmarrësve disagreguar sipas zonave, moshës, aftësive dhe njësive administrative.	Bashkia Cërrik të ketë në vëmendje realizimin e takimeve sensibilizuese me të rinjtë në zonat rurale dhe urbane lidhur me procesin e votimit.

QËLLIMI	VEPRIMI / PROJEKTI	KOHËZGJATJA	TREGUES	Detajime mbi rolin e Bashkisë
2. Nxitja e punësimit të të rejave dhe të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës	2.1. Vlerësimi i kërkesës së tregut të punës dhe traditës apo nevojave specifike të Cërrikut, në lidhje me kurset e formimit profesional që mund të ofrohen në Bashkinë Cërrik.	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Raporti i vlerësimit të situatës. - Propozimet drejtuar Zyrës Rajonale të Punësimit (ZRP) mbi kurset e reja të formimit profesional që duhet të hapen në Cërrik. - Numri i kurseve të reja të hapura.	Bashkia Cërrik mund të luajë rolin e facilitatorit.
	2.2. Organizimi i takimeve sensibilizuese me të rejtat dhe të rinjtë mbi rëndësinë e ndjekjes së kurseve të formimit profesional të bazuara në nevojat dhe specifikat e zonës.	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Numri i takimeve të organizuara në shkollë. - Numri i të rejave dhe të rinjve pjesëmarrës/e në këto takime. - Numri i të rejave dhe të rinjve të regjistruar/a në kurset e formimit profesional.	Bashkia Cërrik ka përcaktuar Plan veprimin për të rinjtë aktivitetet të ndryshme sensibilizuese për punësimin dhe formimin profesional, si: a. Organizimi i një minipanairi me punime artizanale të të rinjve; b. Organizim takimi me ZRP të punësimit me të rinjtë e interesuar; - Zhvillim aktivitetesh me personat me aftësi të kufizuara.
	2.3. Mbështetja e aktiviteteve që nxisin vetëpunësimin e të rejave dhe të rinjve.	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Numri i aktiviteteve vetëpunësuese të mbështetura. - Numri i të rejave dhe të rinjve të vetëpunësuar/a.	Bashkia Cërrik mund të mbështesë me grante ose incentiva fiskale të rinjtë që vetëpunësohen.
	2.4. Seminare informuese dhe trajnuese me nxënës/et e shkollave të mesme mbi rëndësinë e të sfiduarit të stereotipeve gjinore në punësim.	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Numri i seminareve të organizuara. - Lista e pjesëmarrës/eve disagreguar sipas seksit, moshës, klasës dhe njësive administrative.	Bashkia Cërrik mund të luajë rolin e facilitatorit.
	2.5. Panairi i ideve në kuadër të "Ditës Botërore të Aftësive të të rejave dhe të rinjve" ² , bazuar në trajnimet e formimit profesional të ofruara mbi bazën e nevojave dhe karakteristikave të zonës.	<i>15 Korrik 2021 15 Korrik 2022</i>	- Panairi online i organizuar në bashkëpunim me ZRP. - Numri i ideve të prezantuara. - Numri i të rejave dhe të rinjve pjesëmarrës/e.	Bashkia Cërrik mund të luajë rolin e facilitatorit.

² Për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e investimit në zhvillimin e aftësive të të rejave dhe të rinjve, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara vendosi në Rezolutën A/RES/69/145 që data 15 Korrik të njihet si Dita Botërore e Aftësive të të rejave dhe të rinjve (World Youth Skills Day). Për më shumë informacion vizitoni faqen: <http://www.un.org/en/events/youthskillsday/index.shtml>

QËLLIMI	VEPRIMI / PROJEKTI	KOHËZGJATJA	TREGUES	Detajime mbi rolin e Bashkisë
3. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitetet mjedisore dhe turistike	3.1. Nxitja e pjesëmarrjes aktive të të rejave dhe të rinjve në hartimin dhe monitorimin e politikave mjedisore dhe turistike në nivel lokal.	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Numri i të rejave dhe të rinjve që marrin pjesë aktivisht në seancat e Këshillit Bashkiak, dëgjesat publike apo aktivitetet mbi mjedisin, turizmin të organizuara nga bashkia.	Në fokus të projekteve të Bashkisë Cërrik të jetë planifikimi për politikat mjedisore dhe turistike.
	3.2. Aktivitete pastrimi, pyllëzimi, riciklimi, promovimi i turizmit me qëllim rritjen e sensibilitetit të të rejave dhe të rinjve, si dhe komunitetit në tërësi mbi mbrojtjen e mjedisit.	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Numri i aktiviteteve sensibilizuese të organizuara. - Numri i aktiviteteve për promovimin e turizmit të organizuara. - Numri i pemëve të mbjella dhe sasia e plehrave të grumbulluara apo ricikluara.	Kjo është në fokus të punës së Bashkisë.
	3.3. Aktivitete sensibilizuese mbi mjedisin dhe ndikimin e tij në shëndetin e gjeneratës së re.	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Numri i aktiviteteve të zhvilluara. - Numri i të rejave dhe të rinjve pjesëmarrës/e.	Kjo është në fokus të punës së Bashkisë.
	3.4. Aktivitete me të rinjtë që janë larguar nga bashkia për arsye studimesh ose të tjera, me qëllim angazhimin e tyre në aktivitetet që promovojnë kulturën, turizmin dhe vlerat e bashkisë së Cërrikut	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Numri i aktiviteteve të zhvilluara. - Numri i të rejave dhe të rinjve pjesëmarrës/e.	Bashkia Cërrik vë theksin në bashkëpunimin me organizatat për të rinjtë e organizatat rinore shqiptare në diasporë për të mbajtur komunikimin me të rinjtë që janë larguar nga bashkia për arsye studimesh ose të tjera, në mënyrë që të promovojnë vlerat turistike dhe kulturore të Bashkisë përmjet kufijve shqiptarë.

QËLLIMI	VEPRIMI / PROJEKTI	KOHËZGJATJA	TREGUES	Detajime mbi rolin e Bashkisë
4. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitetet artistike e kulturore	4.1. Mbështetje për grupet e reja rinore kulturore dhe artistike (këngë, teatër, animacione) të krijuara nga të rejat dhe të rinjtë e shkollave të Cërrikut dhe përfshirja e tyre në ngjarje apo festa të rëndësishme të qytetit.	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Numri i grupeve të reja rinore të mbështetura. - Numri i aktiviteteve të bashkisë në të cilat janë të ftuara dhe kanë performuar këto grupe rinore.	Përfshirja e të rinjve në aktivitetet artistike-kulturore.
	4.2. Promovimi i jetës artistike dhe kulturore përmes organizimit të aktiviteteve artistike-kulturore në zonat urbane dhe në zonat rurale.	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Numri i aktiviteteve artistike-kulturore të organizuara me mbështetjen e bashkisë, në zonat urbane dhe rurale, me grupet rinore.	Kjo është në fokus të punës së Bashkisë.
	4.3. Programe sensibilizuese në mediat lokale mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në veprimtari sportive, artistike dhe kulturore, përfshirë edhe ato që tradicionalisht shihen si aktivitete kryesisht "femërore" ose "mashkullore".	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Numri i programeve të realizuara. - Përqindja e audiencës së arritur në varësi të shikueshmërisë televizive.	Planifikimi i një sërë projekteve sportive nga Bashkia ku do t'u vihet theksi pjesëmarrjes së barabartë gjinore dhe promovimi i aktiviteteve të të rinjve.

QËLLIMI	VEPRIMI / PROJEKTI	KOHËZGJATJA	TREGUES	Detajime mbi rolin e Bashkisë
5. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete edukuese shëndetësore	5.1. Aktivitete që promovojnë një kulturë të hapur dhe të lirë rreth shëndetit seksual, për të ulur stigmatizmin dhe diskriminimin.	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Numri i aktiviteteve të zhvilluara në shkollat e qytetit dhe në zonat rurale. - Numri i të rejave dhe të rinjve që marrin pjesë.	Bashkia Cërrik mund të luajë rolin e facilitatorit.
	5.2. Krijimi dhe mbështetja e grupeve të "edukatorëve bashkëmoshatarë" ("peer education groups") për nxitjen e organizimit të aktiviteteve edukuese shëndetësore mes të rejave dhe të rinjve në zonat rurale, si dhe në komunitetin Rom, Egjiptjan, LGBTI, etj.	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Grupet e "edukatorëve bashkëmoshatarë" të krijuara. - Numri i aktiviteteve të organizuara nga grupet e "edukatorëve bashkëmoshatarë" me të rejat dhe të rinjtë e zonave apo komuniteteve të caktuara.	Bashkia Cërrik mund të luajë rolin e facilitatorit.
	5.3. Konkurse mes 4 shkollave të mesme të përgjithshme mbi rolin e qeverisjes vendore në çështje të shëndetit seksual dhe riprodhues.	<i>Gjatë ditëve dedikuara shëndetit përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Numri i aktiviteteve të zhvilluara në 4 shkollat e mesme. - Numri i të rejave dhe të rinjve që marrin pjesë.	Bashkia Cërrik mund të luajë rolin e facilitatorit.

QËLLIMI	VEPRIMI / PROJEKTI	KOHËZGJATJA	TREGUES	Detajime mbi rolin e Bashkisë
6. Nxitja e përfshirjes së të rejave dhe të rinjve në aktivitete për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm (Sustainable Development Goals – SDGs)	6.1. Aktivitete informuese mbi SDG-të me qëllim njohjen e tyre dhe sensibilizimin e të rejave dhe të rinjve mbi rolin që mund dhe duhet të luajnë për përmbushjen e këtyre objektivave.	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Numri i aktiviteteve me fokus SDG-të, të organizuara nga bashkia në bashkëpunim me Rrjetin e Organizatave "Zëri i të rinjve" dhe me 4 shkollat e mesme të përgjithshme të qytetit.	Bashkia Cërrik mund të luajë rolin e facilitatorit.
	6.2. Hartimi i planit të veprimeve për përfshirjen e të rejave dhe të rinjve në arritjen e SDG-ve. Zbatimi i planit të hartuar, duke ofruar mbështetjen e duhur financiare, infrastrukturore, etj.	<i>Përgjatë viteve 2021-2022</i>	- Dokumenti i Planit të Veprimeve për arritjen e SDG-ve përmes kontributit të të rejave dhe të rinjve. - Numri i iniciativave të financuara nga bashkia, për t'u zbatuar nga të rejat dhe të rinjtë në kuadër të SDG-ve.	Bashkia Cërrik bashkëpunon me shkollat e mesme.

ÇFARË HAPASH DUHET TË HEDHË BASHKIA PARALELISHT ME PËRFSHIRJEN NË BUXHETIN E VITIT 2022 TË DISA PREJ VEPRIMEVE TË PROPOZUARA MË SIPËR?

- Të marrë masa për fuqizimin e funksionimit të Bordit rinor në përbërjen e të cilit të ketë përfaqësim të barabartë jo vetëm në gjini, por edhe duke respektuar karakteristika të tjera të tilla si vendbanimi, moshë, etnia, nevojat e veçanta, orientimi seksual, etj.
- Të marrë masa të menjëhershme për të siguruar një bazë të saktë të dhënash (databazë) në lidhje me numrin e të rejave dhe të rinjve në qytet dhe zonat rurale pjesë e territorit të bashkisë, duke siguruar që kjo bazë të dhënash të përmbajë detaje mbi gjininë, moshën, nevojat e veçanta të tyre, etninë, etj.
- Të bashkëpunojë me Rrjetin e Organizatave “Zëri i të Rinjve” me qëllim ofrimin e modelit për nxitjen e krijimit të grupeve dhe shoqatave rinore, nga të rejtat dhe të rinjtë e qytetit dhe të zonave rurale pjesë e territorit të bashkisë.
- Të organizojë sesione të hapura dhe dëgjesa publike me fokus të veçantë të rejtat dhe të rinjtë dhe nevojat e tyre. Për të siguruar pjesëmarrjen në këto sesione e dëgjesa, të organizojë fillimisht takime të shkurtra informuese në shkollat e qytetit dhe të zonave rurale, ku të ftohen të rejtat dhe të rinjtë të bëhen pjesë e dëgjesave që do të organizojë bashkia. Në këto takime duhet të paraqitet dhe kalendari i dëgjesave që mendohet të organizohen. Një kopje e këtij kalendari me datat, oraret dhe vendin e organizimit të këtyre dëgjesave, duhet të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë.
- Të marrë masa që të koordinojë aktivitetet shëndetësore, edukuese e kulturore me prioritetet që lidhen me rininë në këto drejtime. Të mundësojë shkëmbime eksperiencash me bashki të tjera ku grupimet rinore janë më aktive.
- Të marrë masa që në takimet dhe dëgjesat për përfundimin e buxhetit vjetor 2022, të sigurojë pjesëmarrjen e të rejave dhe të rinjve nga grupe të ndryshme (përfshirë edhe nga grupet e pafavorizuara si Romë, Egjiptjanë, PAK, LGBTI, etj). Bashkëpunimi me Rrjetin e Organizatave “Zëri i të Rinjve” është i domosdoshëm në këtë drejtim, sidomos për të siguruar pjesëmarrjen e të rejave dhe të rinjve nga grupet e ndryshme të sipërcituara, të rejave dhe të rinjve nga zonat rurale, etj.

TË BUXHETOJMË PËR RININË ME RININË

BASHKIA ÇËRRIK



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



United Nations
ALBANIA



Leave
No One
Behind

